

# STATUTI

## **Kreu I**

### **Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

#### **Neni 1**

##### **Data e Themelimit, Emri, Themeluesit**

- 1) Sot, më 18 gusht 2022, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "ROMINA" SH.P.K.
- 2) Themeluesit e shoqërisë janë: Elvis Gjini me ID J80407029M
- 3) Emri i shoqërisë është "ROMINA"

#### **Neni 2**

##### **Emri**

- 1) Emri i shoqërisë është "Romina", për të cilin shoqëria gëzon të drejtën e markës kundrejt të gjithë të tretëve.
- 2) Elementë të tjerë të markës që shoqërojnë emrin si emblema/sigla/stema do të zhvillohen me vonë dhe do të pasqyrohen statut.

#### **Neni 3**

##### **Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitet të përgjithshëm dhe njëkohësisht edhe aktivitete të specializuara në fusha të ndryshme të teknologjisë, shkencës dhe inovacionit. Objekti primar i aktivitetit do të jetë ofrimi i konsulencave dhe aktiviteteve të tjera juridike.

#### **Neni 4**

##### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.

#### **Neni 5 Selia (HQ)**

Selia (HQ) e shoqërisë ndodhet në adresën: Lezhë, autostrada Lezhe-Tiranë, km 6, 500 m nga kryqëzimi i Rrilës. Kodi postar 4509

Selia (HQ) e shoqërisë mund të ndryshohet kurdoherë në të ardhmen pa qënë e nevojshme që të bëhen ndryshime në statut.

## **Kreu II**

### **Kapitali**

#### **Neni 6**

##### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është në vlerën 100 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme: 1. Ortaku themelues Elvis Gjini : Zoterues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 100 lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi i ortakëve është në para, dhe ai është paguar nga ana e ortakut themelues.

#### **Neni 7**

##### **Kuota**

Kapitali i shoqërisë ndahet në 1 kuotë, e cila përbën 100 % të kapitalit.

#### **Neni 8**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i Kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet:

- 1) Investimit të fitimeve të shoqërisë në capital
- 2) nëpërmjet rritjes së kapitalit fillestar nga ortaku themelues,
- 3) nëpërmjet pranimi të ortakëve të rinj,
- 4) nëpërmjet përthithjes së shoqërive të tjera.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 9**

##### **Transferimi i aksioneve**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj

Në çdo rast ortaku themelues gëzon të drejtën e parablerjes së kuotës. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

## **Kreu III**

### **Organet vendimmarrëse dhe drejtuese**

#### **Neni 10**

##### **Organi vendimmarrës**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj dhe statut. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite

#### **Neni 11**

##### **Mënyra e thirrjes së asamblesë së përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 12**

##### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se

gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 13**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

### **Neni 14**

#### **Administrimi**

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Në rast se pas mbarimit të mandatit 5 vjeçar nuk ka një vendim të asamblesë së përgjithshme për emërimin e një administrator të ri, atëherë konsiderohet se mandati i administratorit është ripërtëritë automaikisht. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë, efektet juridike të emërimit të tyre fillojnë nga momenti i rregjistrimit të shoqërisë në QKB. Të dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit: (emrat, mbiemrat, nënshkrimet):

ELVIS GJINI

nënshkrimi



### **Neni 15**

#### **Kompetencat e administratorit**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së

veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur: -sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë që lidhen me shpërblimin e administratorit në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërië rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi

## **Neni 16**

### **Përgjegjësitë e administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet: 1.

a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **Kreu IV**

### **Prishja & riorganizimi i shoqërisë**

#### **Neni 17**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;

#### **Neni 18**

##### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi dhe ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

## **Kreu V**

### **Ndryshimi i statutit dhe baza ligjore**

#### **Neni 19**

##### **Ndryshimi i statutit**

Statuti i shoqërisë mund ti nënshtrohet shtesave dhe ndryshimeve vetëm sipas procedurës dhe parashikimeve të bëra në këtë statut. Ndryshimet në statut mund të bëhen vetëm me miratimin dhe votën e ortakëve që zotërojnë vetëm ose sëbashku mbi 70 % të kuotave të shoqërisë.

## **Neni 20**

### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do tëzbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 21**

### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ ROMINA ”**

**ELVIS GJINI**



(emër mbiemër nënshkrimi)

**Datë 18 Gusht 2022**